



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit, datat paraprake të seancave janë caktuar më 17, 18 dhe 19 gusht 2026, bazuar në një kërkesë paraprake të një pale për dëgjimin e një dëshmitari.

Më 8 korrik, Gjykatësi i Vetëm lëshoi një urdhër të ri lidhur me zhvillimin e mëtejshëm të procesit, duke u kërkuar palëve të njoftojnë Gjykatën jo më vonë se më 15 korrik nëse synojnë të paraqesin prova të tjera si përgjigje ndaj dëshmisë së një dëshmitari të pranuar para pak kohe.

Në lidhje me shqiptimin e aktgjykimit në çështjen *Thaçi dhe të tjerë* lidhur me krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, i caktuar më datë 16 shtator, dëshiroj t'u kujtoj mediave dhe publikut se afati i aplikimeve për pjesëmarrje në seancën e shqiptimit të aktgjykimit nga galeria publike në Hagë është nesër, më 24 korrik. Për shkak të interesimit të lartë për pjesëmarrje, nuk do të pranohen kërkesa për regjistrim pas skadimit të këtij afati.

Dëshiroj të theksoj gjithashtu se vetëm personat që kanë marrë konfirmimin me postë elektronike do të lejohen të marrin pjesë në seancë nga galeria publike.

Kërkoj mirëkuptimin e gjithë atyre të cilëve nuk mund t'u konfirmojmë regjistrimin, pasi numri i vendeve në galerinë publike është i kufizuar dhe numri i kërkesave ka qenë shumë i lartë. Kujtojmë se seanca mund të përcillet gjithashtu përmes faqes së internetit të Dhomave të Specializuara në tri gjuhët e Gjykatës, shqipe, serbishte dhe anglishte.

Dhomat e Specializuara vijojnë publikimin e një serie videosh që trajtojnë pyetje të shpeshta lidhur me Gjykatën dhe punën e saj. Këto video mund të shikohen në shqip, serbisht, ose anglisht në faqen e internetit si edhe në kanalet YouTube, X, dhe Instagram të Dhomave të Specializuara.

Periudha e pushimit të Gjykatës këtë verë fillon të hënën, më 27 korrik. Gjatë kësaj periudhe, nuk do të ketë seanca apo përditësim për shtypin, por aktivitetet e tjera të Gjykatës do të vijojnë pa ndërprerje. Rrjedhimisht, përditësimi për shtyp i radhës është caktuar të martën, më 20 gusht në orën 14:30.

